ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **623-25-947-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizimi me ushqim dhe me pije për pacientët në hemodializë**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**HEALTHY & FRESH L.L.C.**
NUI	**812013803**
Adresa	**Rruga Fahredin Hoti 1**
Vendi	**Prizren**
Kodi postar	**20000**
Numri Telefonit	**046/420-000**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Xhemile Tershani**
Adresa elektronike	**healthy.llc@hotmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**20.05.2025**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizimi me ushqim dhe me pije për pacientët në hemodializë

1.Njoftimi për kontratë, 20.02.2025,

2.Procesverbali i hapjes, 13.03.2025,

3.Vlera e kontratës, 29,160.00 €,

4.Lloji i procedurës, Procedurë e hapur,

5.FPP, 15000000-8 Produkte ushqimore dhe pije,

6.Njoftimi për dhënie, 08.04.2025,

7.Njoftimi mbi vendimin e AK (fitues), 01.04.2025,

8.Disponueshmëria e fondeve, 01.04.2025,

9.Njoftim mbi vendimin e AK (anulim), 16.05.2025.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Me datën 19.05.2025 kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim sipas Nenit 108/A të LPP-së.

Po të njejtën datë më 19.05.2025 Autoriteti Kontraktues ka bërë pezullimin e aktivitetit të prokurimit, mirëpo edhe përkundër kësaj AK nuk ka shqyrtuar fare

pretendimet ankimore sipas rregullave dhe dispozitave ligjore të Prokurimit Publik dhe del me një vendim në lidhje me kërkesën për rishqyrtim duke e refuzuar pa asnjë përgjigje.

Andaj detyrohemi që të paraqesim ankesë sipas Nenit 109 të LPP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik:

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi,
Neni 9 - Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur,
Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit,
Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik:

Neni 43 - Ndërprerja e procedurave të prokurimit,
Neni 64 - Paraqitja e ankesës dhe afatet kohore për dorëzimin e një ankese në OSHP.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar,

Si palë me interes konform Nenit 4.1.26 të LPP-së, si palë e pa kënaqur me njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 16.05.2025 dhe vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 19.05.2025, konform Nenit 109 të Ligjit për Prokurimin Publik në afatin e lejuar ligjor bazuar dhe Nenit 64.1 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik paraqesim këtë:

A N K E S Ë

Të pa kënaqur me njoftimin mbi vendimin e AK-së të datës 16.05.2025 për anulimin e aktivitetit të prokurimit, pas publikimit të Njoftimit për dhënie të kontratës të datës 08.04.2025 në platformën e E-prokurimit, konform Nenit 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik në afatin e lejuar ligjor bazuar edhe në Nenin 60 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, me datën 19.05.2025 kemi paraqitur "***kërkesë për rishqyrtim***" ndaj aktivitetit të prokurimit me titull: ***Furnizimi me ushqim dhe me pije për pacientët në hemodializë*** me nr.prokurimi: ***623-25-947-1-2-1*** e inicuar nga Kuvendi Komunal i Rahovecit.

Me datën 19.05.2025 Autoriteti Kontraktues nxjerr vendim mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, dhe po me të njejtën datë nxjerr edhe vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar.

Autoriteti Kontraktues nuk i përgjigjet fare pretendimeve tona ankimore të cilat i kemi parashtruar me rastin e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim dhe nuk jep asnjë arsyetim në lidhje me pretendimet tona e që e ka për obligim që të përgjigjet sipas rregullave dhe dispozitave tjera ligjore konform Ligjit për Prokurimin Publik. Të njejtët si arsyetim e përdorin përgjigjen e Drejtorisë përkatëse që kanë kërkuar anulimin e kësaj procedure.

Provë: *Vendimi i Autoritetit Kontraktues, të datës 19.05.2025.*

Për shkak se AK: Kuvendi Komunal i Rahovecit:

- Në mënyrë të kundërligjshme e ka anuluar aktivitetin e prokurimit me të dhënat e lartëcekura, duke mos rrespektuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues me datën 13.03.2025 ka bërë hapjen e ofertave, ku sipas procesverbalit të hapjes kanë qenë vetëm dy ofertues. Pas vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të ofertave me datën 01.04.2025 Autoriteti Kontraktues ka dal me një vendim për rekomandimin e fituesit në këtë rast ofertën e kompanisë sonë si oferta më e lirë e përgjegjshme.

Me datën 01.04.2025 në platformën e E-prokurimit është ngarkuar Njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve, ku ka pasur konfirmim se janë mjetet e zotuara për këtë aktivitet të prokurimit.

Provë: *Njoftimi mbi vendimin e AK-së, datë 01.04.2025,*
Provë: *Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve, datë 01.04.2025.*

Me datën 08.04.2025 pasi që nuk ka pasur asnjë ankesë/kërkesë për rishqyrtim brenda afatit të lejuar ligjor, Autoriteti Kontraktues ka bërë publike **Njoftimin për dhënie të kontratës**.

Provë: *Njoftimi për dhënie të kontratës, datë 08.04.2025.*

Neni 7 i LPP-së par. 1 thotë: ***Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në***

mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Në njoftimin e publikuar në platformën e E-prokurimit, Autoriteti Kontraktues ka bërë publikimin e Njoftimit mbi vendimin e AK-së me datën 16.05.2025 duke bërë Anulimin e aktivitetit të prokurimit në arsyetim se: **Me shkresë nga Njësia Kërkuese nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesjes Sociale, kërkon që të anulohet ky aktivitet i prokurimit duke cekur: Ju njoftojmë se në këtë kod buxhetor, nuk ka mjete buxhetore për shkak se janë shpenzuar nga thesari. Andaj nuk mund të bëjmë kontrata pa sigurim të mjeteve financiare. Referoheni shkresës së Njësisë Kërkuese të dërguar me e-mail të bashkangjitur në këtë Vendim.**

Ky arsyetim nuk është aspak ligjor dhe është në kundërshtim me rregullat dhe dispozitat ligjore të Prokurimit Publik.

Neni 62 i LPP-së par. 1, dhe par. 2 përcaktojnë mënyrën dhe arsyet kur mund të përfundoj një aktivitet të prokurimit, poashtu Neni 43.5 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: ***Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:*** ***a.*** *asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;* ***b.*** *asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;* ***c.*** *numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);* ***d.*** *nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;* ***e.*** *numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3;* ***f.*** *nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;* ***g.*** *asnjë nga projektet e pranuara në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;* ***h.*** *nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;* ***i.*** *një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;* ***j.*** *nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose* ***k.*** *nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.*

Neni 43.7 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik thotë: ***Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave mund të anulohet për arsyen e mëposhtme: a. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK.***

Pra arsyetimi i Autoritetit Kontraktues nuk është konform dispozitave të lartëcekura, dhe se çuditërisht përdoret një arsyetim i till kur ekziston dokumenti *Deklarata e nevojave dhe përcaktimit të disponueshmërisë së fondeve, datë 01.04.2025* se mjetet janë të zotuara për këtë aktivitet të prokurimit.

Në vendimin e publikuar të AK-së,e cila është e pabazë dhe tendencioze vetëm e vetëm që të mos përzgjidhemi si fitues i kësaj kontrate, pasi që të njejtët kanë dështuar në përzgjedhjen si fitues të operatorit ekonomik të cilin e favorizojnë haptazi, e që dëmet e shkaktuara që po na bëhen në këtë procedurë do ti drejtojmë tek organet kompetente për të kërkuar të drejtën tonë për trajtimin jo të barabartë dhe mohim të së drejtës për shpërblim me kontratë, pasi që në këtë aktivitet të prokurimit kemi qenë të përgjegjshëm që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) ku Qëllimi i këtij nenin është që Autoriteti Kontraktues ti trajtoj në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik dhe jo në mënyrë diskriminuese dhe poashtu të veproj në mënyrë transparente.

Sipas Nenit 1 të LPP-së, *Qëllimi i këtij ligji është që të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfyrtëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.*

Me ç'rast kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që pas analizimit të të gjitha pretendimeve tona ankimore në lidhje me shkeljet e supozuara të dispozitave ligjore që janë në fuqi, të nxjerr:

V E N D I M

1. **APROVOHET** si e bazuar ankesa jonë për rishqyrtim në lidhje me aktivitetin e prokurimit *dhe*

2. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e procedurës lidhur me aktivitetin e prokurimit dhe lënda të kthehet në ***Rivlerësim.***

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Ofertues në këtë aktivitet të prokurimit kemi shpenzime të konsiderueshme për rishqyrtim të vendimit në AK në përgatitjen e dokumentacionit (ofertës) dhe pjesëve të tjera të cilat ndërlidhen me këtë procedurë të prokurimit si: shpenzimet për përgatitjen e ankesave si në fazën e parë dhe atë të dytë, përfaqësimeve të cilat ndodhin etj.

Dëmi reflekton në dëmin material dhe jo-material e i cili shtrihet edhe në raport me Neni 136 dhe Neni 137 të LMD-së duke mos u kufizuar edhe në dëmin e imazhit dhe pasojave të tjera që në këtë fazë nuk janë në tërësi të konkretizuara.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,

f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*